LIGJ
Nr.8203, datë 30.3.1997

PËR PRANIMIN NË SHQIPËRI TË NJË FORCE USHTARAKE SHUMËKOMBËSHE NË MBËSHTETJE TË OPERACIONEVE HUMANITARE

Duke pasur parasysh situatën tepër të vështirë të krijuar në Shqipëri për shkak të shkeljeve masive të rendit kushtetues dhe ligjor, bazuar në vullnetin e përbashkët të të gjithë forcave politike dhe duke iu referuar dispozitave përkatëse të Kartës së Organizatës të Kombeve të Bashkuara dhe dokumenteve të OSBE-së, në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat krysore kushtetuese" me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Pranimin në Shqipëri të një force ushtarake shumëkombëshe për të ndihmuar autoritetet legjitime shqiptare në përballimin e problemeve lidhur me gjendjen e sigurisë në vend.

Neni 2

Forca ushtarake duhet të jetë shumëkombëshe, të veprojë për një kohë të kufizuar e në kuadrin e organizatave ndërkombëtare të specializuara dhe të ketë si detyrë kryesore mbështetjen e autoriteteve legjitime shqiptare, për të siguruar kryerjen e papenguar të të gjithë veprimtarisë për dërgimin në destinacion të ndihmave humanitare.

Neni 3

Këshilli i Ministrave ngarkohet të paraqesë për miratim në Kuvendin Popullor brenda një periudhe sa më të shkurtër të gjithë kuadrin ligjor të nevojshëm në bazë të ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese ku të përcaktohen me saktësi mandati, statusi, vendndodhja e mënyra e veprimit të këtyre forcave shumëkombëshe në Shqipëri.
Ndërkaq i hapet rruga fillimit të opercionit.

Neni 4

Forca ushtarake shumëkombëshe bashkërendon veprimet e saj vetëm me Këshillin e Ministrave dhe autoritetet e tjera legjitime shtetërore në nivel qendror e lokal.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi më datën 30.3.1997.

Shpallur me dekretin nr.1770, datë 30.3.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha